

MBI AUDITIMIN E USHTRUAR NË BASHKINË RRËSHEN

Raporti Përfundimtar i Auditimit të ushtruar në Bashkinë Rrëshen me objekt: “Mbi vlerësimin e aktivitetit ekonomik e financiar, procedurat e shqyrtimit dhe miratimit të studimeve urbanistike, shesheve e lejeve të ndërtimit, lejeve të shfrytëzimit, administrimin e aseteve, vlerësimin për shitje të trojeve nën objekt, shitjen e trojeve, dhënien me qira të objekteve pronë publike, funksionimi i policisë bashkiake, vlerësimi i auditit të brendshëm, etj” dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me Vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 103, datë 30.6.2012.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 "Për Kontrollin e Lartë të Shtetit", ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, me shkresën nr. 153/6, datë 30.6.2012, dërguar z. **Ndue GEGA**, Kryetar i Bashkisë, krahas Raportit Përfundimtar të Auditimit, Kontrolli i Lartë i Shtetit i ka rekomanduar dhe kërkuar zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1. Në zbatim të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore” nenin 32 “detyrat dhe kompetencat e Këshillit Komunal ose Bashkiak”, të hartohet dhe miratohet Rregullorja e Brendshme e Bashkisë “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e Administratës së Bashkisë Rrëshen”.

Menjëherë

2. Në zbatim të neneve 12, 21 dhe 37 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 “Për Kodin e Punës”, i ndryshuar, të lidhen kontratat individuale me punonjësit e Bashkisë, ku të parashikohen edhe llojet e masave disiplinore.

Menjëherë

3. Të përgatitet dokumentacioni për nxjerrjen në ankand të autoveturës tip Benz, në zbatim të VKM nr. 1242, datë 16.12.2009 “Për rregullat e funksionimit të komisionit të ankandit, procedurat e zhvillimit të ankandit, kriteret e vlerësimit të pronës, që nxiret në ankand, si dhe për mënyrën e indeksimit të përfitimit financiar mujor”.

Menjëherë

4. Bashkia Rrëshen në përputhje me VKM nr. 529, datë 8.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve të procedurës dhe mënyrës së dhënies me qira enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, të lidhë kontratën e qirasë:

- për automjetin pronë e bashkisë dhënë në përdorim subjektit të pastrimit [REDACTED]
- për 2 ambientet e dhëna me qira subjekteve private.

Menjëherë

5. Të analizohet me grup pune, duke nxjerrë përgjegjësinë konkrete të marrjes në dorëzim të Planit të Përgjithshëm Rregullues të Territorit të qytetit Rrëshen, njëkohësisht të nxirren në mënyrë analitike defektet e këtij plani dhe të iniciohet me studion e projektimit [REDACTED] për të riparuar mangësitë e dala.

Menjëherë

6. Nga Sektori i Taksave dhe Tarifave Vendore, të merren masat si më poshtë:

a. Në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 10.279, datë 20.5.2010 “Për Kundërvajtjet Administrative”, të hartohet paketa e llojeve dhe masa e gjobës për çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative duke e miratuar në Këshillin Bashkiak.

b. Të hartojë planet vjetore për ushtrimin e kontrolleve sipas pikës 10 “Kontrolli tatimor”, të udhëzimit përbashkët të Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Financave nr. 655/1, datë 6.02.2007.

c. Vjelja e taksës për zënie hapësire publike, të bëhet sipas sipërfaqeve të miratuara dhe të lidhen kontrata mes tregtarëve dhe Bashkisë. Të studiohet mundësia e rritjes të nivelit të tarifës së pastrimit për çdo familje dhe të miratohen në Këshillin Bashkiak. Të vilet tarifa veterinare për vlerën 32,000 lekë sipas evidencës për numrin e therjeve.

d. Të merren masa për arkëtimin e debitorëve të taksave vendore të biznesit të vogël për vlerën 1,6 milion lekë.

Menjëherë

7. Nga Policia Bashkiake të merren masat si më poshtë:

a. Arkëtimi i 21 gjobave për vlerën 10,500 lekë të vendosura për zënie hapsire publike, për ndotje ambjenti në trotuar si dhe për parkim të gabuar sipas listës bashkëngjitur.

b. Në bashkëpunim me Zyrën e Taksave, të evidentohen furgonat taksi të palicencuara dhe të bëhet regjistrimi i tyre, në të kundërtën të zbatohen sanksionet ligjore përkatëse.

c. Korrespondenca me Zyrën e Taksave të bëhet zyrtarisht nëpërmjet Zyrës së Protokollit.

Menjëherë

8. Nga ana e Bashkisë të analizohet gjendja e debitorëve duke u hartuar plan veprimi dhe të marrë masa për arkëtimin e tyre për vlerën **8,475 mijë lekë**, nga të cilat:

- 1,669 mijë lekë për 40 debitorë të taksave vendore;
- 5,442 mijë lekë për 158 debitorë të tjerë;
- 368 mijë lekë për 104 debitorë të çerdhes së qytetit;
- 154 mijë lekë për 42 debitorë të konviktit qytetit dhe
- 842 mijë lekë për 146 debitorë kopshtit qytetit, sipas listave bashkëlidhur.

Menjëherë

9. Të kërkohet në rrugë ligjore, arkëtimi i taksës vendore për vlerën **217,960 lekë**, nga 8 subjekte të biznesit të madh për vitin 2011 dhe konkretisht:

- ■■■ 25,320 lekë, ■■■ 25,320 lekë, ■■■ 39,120 lekë, ■■■ 24,120 lekë, ■■■ 24,120 lekë, ■■■ 24,120 lekë, ■■■ 31,720 lekë dhe ■■■ 24,120 lekë.

Menjëherë

10. Të llogariten kamat vonesat e mos pagesës në afat të taksës së ndikimit në infrastrukturë, përkatësisht: Investitorit ■■■ mbi vlerën **9,362,055 lekë**; Investitorit, ■■■ mbi vlerën **1,168,000 lekë**.

Menjëherë

11. Nga ana e Zyrës së Urbanistikës, të mos i jepet Leja e Shfrytëzimit Investitorit ■■■ pa u paguar taksa e ndikimit në infrastrukturë, për objektin “Ndërtim tende druri, lokal, Prishtina”. Leja e ndërtimit miratuar me vendimin e KRRT nr. 01, datë 10.3.2009, zbardhur më datën 24.3.2009.

Menjëherë

13. Në zbatim të VKM nr. 444, datë 5.9.1994 “Për tarifatat e studimit, projektimit, drejtimit dhe kolaudimit të veprave të ndërtimit” Shkronja A- Tarifatat në përqindje për studimin e projektimit, drejtimit dhe likuidimit e punimeve, të bëhet ndryshimi i kontratës nr. 2442, datë 01.8.2011, për objektin “Sistemim-Asfaltim rruga Rrëshen Kodër Rrëshen (faza IV), në lidhje me pagesën e mbikëqyrësit të punimeve ■ nga 376,700 lekë në 319,423 lekë, ose **57,270 lekë** më pak.

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIMIN E DËMIT

Të kryhet kontabilizimi dhe të kërkohet në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit për shpërblimin e dëmit me vlerë **14,290,949 lekë**, në mënyrë analitike si më poshtë:

1. Vlera prej **9,362,055 lekë**, ndaj subjektit ■ për objektin “Godinë banimi 8 kat + 2 kat shërbime + 1 kat parkim nëntokë”, i cili nuk ka paguar taksën e ndikimit në infrastrukturë dhe aktmarrëveshjes nr. 286, datë 21.01.2011, të lidhur me Bashkinë Rrëshen.

Menjëherë

2. Vlera prej **1,168,000 lekë**, ndaj subjektit ■ për objektin: “Kompleks shërbimesh 5 kat + bodrum + karburant”, i cili nuk ka kryer pagesën e plotë për vlerën e llogaritur për taksën e ndikimit në infrastrukturë.

Menjëherë

3. Vlera prej **18,355 lekë**, ndaj subjektit ■ për objektin: “Kompleks Rritje Derri”, për llogaritje të gabuar të vlerës së taksës së ndikimit në infrastrukturë, pasi nga 185,873 lekë, që duhej të paguante, i janë llogaritur 167,517 lekë.

Menjëherë

4. Vlera prej **679,979 lekë**, ndaj investitorit ■ sh.p.k për objektin: “Godinë shërbimesh 2 kat + 7 kat për banim +1 kat parkim (bodrum) nëntokë”, e cila përfaqëson diferencën e llogaritur më pak, taksë e ndikimit në infrastrukturë. Nga ana e Zyrës së Urbanistikës, të mos i jepet Leja e Shfrytëzimit, pa u paguar detyrimi i mësipërm.

Menjëherë

5. Vlera prej **739,000 lekë**, ndaj subjekti ■ pasi në preventivin e objektit është përfshirë edhe vlera e pajisjeve së bashku me t.v.sh. duke rritur artificialisht fondin limit dhe kontratën. Likuidimi është kryer me urdhër shpenzimit nr. 62, datë 11.04.2011, sipas faturës tatimore nr. 2, datë 6.4.2011, në kundërshtim me UKM nr. 2, datë 8.5.2003 “Për klasifikimin dhe strukturën e kostos të punimeve të ndërtimit” Kreut I, pika 1, A ku përcaktohet: “Në punimet e ndërtimit në të gjitha rastet përjashtohen aparaturat dhe pasjet”.

Menjëherë

6. Vlera prej **447,162 lekë**, diferencë në pagesën e qirasë së 2 objekteve, si më poshtë:

a. Vlerën **366,240 lekë**, ndaj subjekti ■ diferencë në pagesën e qirasë për vitin 2011, sipas kushteve të përcaktuara në kontratën datë 15.08.2006, të lidhur me Bashkinë për objektin: “Në ambientet e Pallatit të Kulturës Rrëshen”.

b. Vlerën prej **80,922 lekë**, ndaj subjektit ■ diferencë në pagesën e qirasë për vitin 2011, sipas kushteve të përcaktuar në kontratën datë 10.02.2010.

Menjëherë

7. Vlera prej **288,000 lekë**, Subjekti [REDAKTUAR] e cila përfaqëson mos pagesën e vlerës së qerasë për 3 vitet 2009, 2010 dhe 2011, për ambientin tek ish-Komiteti Ekzekutiv një sipërfaqe prej 102.6 m² sipas kontratës datë 30.3.2006,

Menjëherë

8. Vlera prej **138,940 lekë**, përkatësisht nga [REDAKTUAR] 46,313 lekë, [REDAKTUAR] 46,313 lekë dhe [REDAKTUAR] 46,313 lekë, respektivisht sipas urdhër shpenzimit nr. 274, datë 13.12.2010, për fotokopjime të pajustificuara, sipas urdhër të shpenzimit nr. 247 datë 25.10.2010 dhe procesverbalit të komisionit datë 22.11.2010.

Menjëherë

9. Vlera prej **34,765 lekë**, likuiduar më tepër në situacion subjektit [REDAKTUAR] për pastrimin e gjelbërimit e qytetit, veprim ky në kundërshtim me kontratën shtesë datë 01.6.2009 dhe nenin 13/ç të ligjit nr. 10296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

10. Vlera prej **24,750 lekë**, pagesa të tepërta në krahasim me dokumentacionin justifikues, përkatësisht ndaj subjekteve: [REDAKTUAR] 2,250 lekë; [REDAKTUAR] 13,500 lekë; [REDAKTUAR] 9,000 lekë, në kundërshtim me nenin 13/ç të ligjit nr. 10.296 datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

11. Vlera prej **303,000 lekë**, përfituar më tepër udhëtim e dieta, në kundërshtim me VKM nr. 228, datë 13.4.2001 dhe VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit” pika 3/1 dhe III/3/b.

Menjëherë

12. Vlera prej **128,000 lekë**, për shpenzime pritje përcjellje të kryera në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 243, datë 15.5.1995, i ndryshuar, sipas listave emërore të pjesëmarrësve në dreka që disponohen pranë Bashkisë Rrëshen.

Menjëherë

13. Vlera prej **219,356 lekë**, nga magazinierja [REDAKTUAR] për diferencë të artikullit bukë, veprim në kundërshtim me nenin 6 pika 6/2 “specifikimet teknike” përkatësisht të kontratës datë 01.12.2010 dhe 12.12.2011, si dhe nenin 13/ç të ligjit nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar e kontrollin”.

Menjëherë

14. Vlera prej **580,500 lekë**, për tarifë reklame të papaguar, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar, nga 10 subjekte e përkatësisht:
- V. 243,000 lekë; Karburant [REDAKTUAR] 67,500 lekë; Karburant [REDAKTUAR] 40,500 lekë; Karburant [REDAKTUAR] 67,500 lekë; Karburant [REDAKTUAR] 67,500 lekë; [REDAKTUAR] 13,500 lekë; [REDAKTUAR] 27,000 lekë; Bar-Restorant [REDAKTUAR] 13,500 lekë; Bar-Restorant [REDAKTUAR] 27,000 lekë dhe Supermarket [REDAKTUAR] 13,500 lekë. Me këta subjekte për tarifën e reklamës të lidhen kontratat përkatëse.

Menjëherë

15. Vlera prej **15,500 lekë**, përfituar më tepër kompensim ushqimor, përkatësisht: [REDAKTUAR] 6,000 lekë [REDAKTUAR] 6,000 lekë dhe [REDAKTUAR] 3,500 lekë, në kundërshtim me pikën 1, të VKM nr. 499, datë

13.8.1998, i ndryshuar me VKM nr. 683, datë 28.10.1998 “Për shpërblimin mujor të punonjësve me më shumë se 3 persona në ngarkim në familje”.

Menjëherë

16. Vlera prej **19,638 lekë**, ndaj ■■■ përfiturar më tepër shpërblim për lejen e zakonshme 2010, sipas urdhrit nr. 85, datë 30.6.2010, veprim në kundërshtim me kreun II/6 të VKM-së nr. 551, datë 24.10.2002, i ndryshuar.

Menjëherë

17. Vlera prej **4,900 lekë**, ndaj ■■■ shpenzim i pa justifikuar për blerje pasaporte, në kundërshtim me ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

Menjëherë

18. Vlera prej **119,049 lekë**, ndaj subjektit ■■■ e cila përfaqëson tatim në burim, subjekt i cili nuk është i regjistruar në Bashkinë Rrëshen dhe nuk ka paguar detyrimin tatimor, në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 8438 datë 28.11.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar.

Menjëherë

Shënim: Përveç vlerës rekomanduar më sipër për shpërblim dëmi prej **14,290,949 lekë**, gjatë periudhës së auditimit u arkëtua edhe vlera **469,015 lekë**, përkatësisht: Subjekti ■■■ 399,895 lekë taksë ndikimi në infrastrukturë; 7 persona për kompensimin e energjisë elektrike në vlerën 61,920 lekë dhe qytetari ■■■ pagoi vlerën e qirasë prej 7,200 lekë.

C. MASA ADMINISTRATIVE

a) Në zbatim të nenit 72 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, Kreu X, të kërkohet nga Agjencia e Prokurimit Publik që, për shkeljet e konstatuara në zhvillimin e procedurave të prokurimeve publike kërkohet të ndëshkohen për Kundërvajtje Administrative në shumat respektive të përcaktuara për secilin nga punonjësit e mëposhtëm:

1. Për zj. ■■■ në cilësinë e juristes të njësisë së prokurimit dhe e ngarkuar për sistemin elektronik, gjobë në masën **50.000 lekë**, për shkeljet e mëposhtme:

- për mos nënshkrimin edhe nga dy anëtarët e njësisë së prokurimit, të proces verbalit datë 21.05.2010 hartuar për miratimin e dokumenteve të tenderit, me objekt: “Ndërtim i Vend depozitës së Mbetjeve të ngurta Urbane”. Veprim në kundërshtim me pikën 2 të nenit 12, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu V, pika 2, germa “a”.

- nuk ka dorëzuar për çdo 4 muaj në APP, raportet e veprimtarisë së prokurimit, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 12, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

b) Mbështetur në nenet 4, 5 dhe 15 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar, kërkohet të ndëshkohen për Kundërvajtje Administrative nga Kryeinspektori i Inspektoratit të Ndërtimit dhe Urbanistikës pranë Bashkisë Rrëshen, në shumat prej **2.000.000 lekë** për secilin nga personat e mëposhtëm:

1. Për z. ■■■ studio ■■■
2. Për z. ■■■ studio ■■■

Pasi në cilësinë e projektuesve dhe preventivuesve në objektin: “Ndërtim i vend depozitës së mbetjeve të ngurta urbane” (faza II), kanë hartuar preventivin duke aplikuar çmimet e zërave

të punimeve për njësi, më të larta se manualët e ndërtimit, ndërsa për 4 zëra punimesh nuk kanë paraqitur analizat e çmimeve, veprime këto në kundërshtim me:

- VKM nr. 30, dt.20.01.2010 “Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre”.

- VKM nr. 514, datë 15.8.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.

D. MASA DISIPLINORE

Mbështetur në nenin 25, pika 3, germat “b” dhe “ç” të ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil”; pika 1, shkronjat “b” dhe “ë”, të VKM nr. 306, datë 13.06.2000 “Për disiplinën në shërbimin civil” dhe Kontratat individuale të punës, bazuar në nenin 44 të ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar, kërkojmë të fillojnë procedurat për dhënien e masës disiplinore, për 12 punonjës si më poshtë:

“Vërejtje me paralajmërim”, neni 25, germa “b”

1. Për z. ■■■ me detyrë inspektor i Zyrës së Taksave Vendore.

2. Për z. ■■■ me detyrë inspektor Zyrës së Taksave Vendore.

- Për mungesë kontrolli ndaj subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje, subjekteve debitorë, subjekteve të mbyllura, subjekteve të aktivitetit të reklamave etj.

- Për mos licencimin e 17 subjekteve që ushtrojnë aktivitet pa leje dhe pa paguar taksat vendore për vitin 2011. Për mos ndjekjen e vlerës debitore prej 882,035 lekë për 33 subjekteve të biznesit vogël për vitin 2011.

- Për mos aplikim sanksione për vonesë e shkelje afati të pagesës së kësteve tatimore ndaj subjekteve të biznesit të vogël.

- Për mos kryerje kontrolli e verifikimi për saktësinë e bazës së tatueshme të deklarimit të xhiros të subjekteve fizike.

3. Për zj. ■■■ me detyrë llogaritëse e pagave dhe magazinës, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mangësi në 4 raste me veprimet e magazinës, në kundërshtim me ligjin nr. 10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Për pagesën tepër kompensime ushqimore në 3 raste për vlerën 15.500 lekë, në kundërshtim me VKM nr. 499 datë 13.8.1998 pika 1 ndryshuar me VKM nr. 683 datë 28.10.1998 pika 1 “Për shpërblimin mujor të punonjësve me më shumë se 3 persona në ngarkim në familje”.

- Për mos bërje hyrje të planit të përgjithshëm rregullues të territorit të Bashkisë Rrëshen, veprim në kundërshtim me kërkesat e nenit 13/c të ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

4. Për zj. ■■■ me detyrë inspektore e Zyrës së Financës, për shkeljet e mëposhtme:

- Për të metat e mangësitë e konstatuara në inventarizimin e pasurisë dhe nxjerrjet jashtë përdorimit, në kundërshtim me VKM nr. 70, datë 11.3.1985 si dhe të ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

- Për mos administrimin dhe lejimin e kamionit të Bashkisë, të përdoret nga firma e pastrimit pa kontratë dhe pa asnjë detyrim qiraje.

5. Për z. ■■■ përgjegjës i Policisë Bashkiake, për shkeljet e mëposhtme:

- Për punë të dobët dhe mungesë efektiviteti të Policisë Bashkiake.

- Për mos vjelje të gjobave në 21 raste për vlerën 10,500 lekë, të vendosura për zënie hapsirë publike, për ndotje ambjenti në trotuar si dhe për parkim të gabuar.

- Për mungesë bashkërendimi me sektorin e taksave vendore, për disiplinimin e 17 subjekteve të palicensuara dhe 33 subjekteve debitorë.

- Për mungesë inspektimi të subjekteve pa leje apo me detyrime të pashlyera.

6. Për z. ■■■ me detyrë supervisor, për shkeljet e mëposhtme:

- Pasi nga mos kontrolli ka lejuar që të likuidohen tepër vlera 34,765 lekë dëm ekonomik në situacionin e punimeve për pastrimin e gjelbërimit e qytetit, në kundërshtim me kontratën shtesë datë 01.6.2009.

- Për mos mbajtjen e procesverbaleve për kontrollin e volumeve dhe cilësisë punimeve të pastrimit sipas situacioneve mujore, në kundërshtim me nenin 17 të kontratës nr. 3324, datë 30.9.2011 dhe me Rregulloren e Bashkisë neni 55.

“Kalim në një detyrë të një niveli apo klasë më të ulët, për një periudhë 1 vjeçare”, neni 25, germa “ç”

1. Për zj. ■■■ me detyrë përgjegjëse e Sektorit të Financës, për shkeljet e mëposhtme:

- Për pagesa dieta të tepërta në vlerën 303,000 lekë dëm ekonomik, në kundërshtim me VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar te punonjëset që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës brenda vendit”.

- Për lejimin e kryerjes së shpenzime për pritje e përcjellje, për vlerën 128,000 lekë, në kundërshtim me kërkesat e VKM nr. 243, datë 15.05.1995 “Për shpenzimet për pritje përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja”, i ndryshuar

- Për mos administrimin dhe lejimin e Kamionit të Bashkisë, të përdoret nga firma e pastrimit, pa kontratë dhe pa asnjë detyrim qiraje.

- Për mos bërje hyrje të studimit urbanistik ose planit rregullues të territorit të Bashkisë Rrëshen për vlerën 3,492,600 lekë, në kundërshtim me kërkesat e nenit 13/c të ligjit nr. 10.296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin”.

2. Për z. ■■■ me detyrë përgjegjës i Sektorit të Taksave Vendore, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos realizim të ardhurave taksave e tarifave vendore për vitin 2010 në masën 64 për qind dhe për vitin 2011 në masën 40 për qind.

- Për mos realizim të disa taksave të cilat kanë pasur mundësi realizimi, si taksa e biznesit vogël, taksa e tokës bujqësore, tarifa e pastrimit, etj.

- Për mos rakordim me sektorët brenda bashkisë dhe Zyrën e Urbanistikës për tarifën e reklamës dhe taksën e infrastrukturës.

- Për mos licencimin e 17 subjekteve që ushtrojnë aktivitetet pa leje dhe pa paguar taksat vendore për vitin 2011.

- Për mos ndjekjen dhe mos vjeljen e vlerës debitorë 882,035 lekë për 33 subjekteve të biznesit vogël për vitin 2011.

3. Për z. ■■■ përgjegjës i Seksionit të Urbanistikës, në cilësinë sekretarit të KRRT-së, që nga data 01.01.2011 e në vazhdim, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos ndjekjen e rrugës ligjore në lidhje me mospagimin e taksës së ndikimit në infrastrukturë, në kundërshtim me nenin 51, të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën”, i ndryshuar, në vlerën 10,530,055 lekë, si më poshtë;

-për vlerën 9,362,055 lekë, ndaj subjektit shoqëria ■■■ për objektin: “Godinë banimi 8 kat + 2 kat shërbime + 1 kat parkim nëntokë”.

-për vlerën 1,168,000 lekë, ndaj subjektit ■■■ për objektin “Kompleks shërbimesh 5 kat +bodrum + karburant”.

- Edhe pse kanë qenë në dijeni të mos pagesës së taksës prej 1,168,000 lekë, ka përgatitur dokumentacionin justifikues dhe ka pajisur Investitorin ■■■ me lejën e shfrytëzimit nr.1612, datë 26.4.2011, për objektin “Kompleks shërbimesh 5 kat +bodrum + karburant”, në kundërshtim me pikën 10 të nenit 22/1 me ligjin nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për urbanistikën”, shtuar me ligjin nr. 8991, datë 23.12.2003.

4. Për zj. ■■■ specialiste e Auditit të Brendshëm Publik, për shkeljet e mëposhtme:

- Për mos zbatim të “Manualit të Procedurave të Auditimit, për auditët e brendshëm dhe karta e auditimit të brendshëm publik, të miratuar me VKM nr. 345, datë 01.06.2004, dhe konketisht:

- në përfundim të auditit për vitin 2010 nuk kishte hartuar Memorandumi (informacion mbi përfundimet e auditimit), në kundërshtim me seksionit V, pika 5, "Memorandumi".

- jo në të gjitha rastet hartohet shkresa e evadimit dhe nuk i është dërguar subjektit të kontrolluar e shoqëruar dhe me raportin final të auditit. Ndërkohë nuk kishte konfirmim zyrtar të raportit final të auditimit, nga subjekti i audituar.

5. Për zj. [REDAKTUAR] me detyrë administrative e ndihmave ekonomike.

-Ka pranuar dhe lejuar tërheqjen e kompensimit për energjinë elektrike, nga vajza e saj [REDAKTUAR] në vlerën 7,680 lekë, në kundërshtim me pikën 1, gjerat "a", "b", "c", të VKM nr. 565, datë 9.8.2006, "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike".

6. Për zj. [REDAKTUAR] administratore e personave me aftësi të kufizuar, pasi:

- Ka pranuar dhe lejuar tërheqjen e kompensimit për energjinë elektrike nga vajza e saj, [REDAKTUAR] në vlerën 13,680 lekë.

- Për mos kontroll të dokumentacionit edhe ndaj 6 personave të tjerë, të cilët kanë përfituar padrejtësisht kompensimin e energjisë elektrike në vlerën 48,240 lekë, në kundërshtim me, pikën 1, gjerat "a,b,c", të VKM nr. 565, datë 9.8.2006, "Për mbrojtjen e shtresave në nevojë, nga rritja e çmimit të energjisë elektrike".

7. Për 8 punonjësit e Bashkisë Rrëshen të cilët nuk janë në marrëdhënie pune me bashkinë dhe për pasojë nuk mund të jepen masat disiplinore, si më poshtë:

- [REDAKTUAR] ish-kryetari i Bashkisë Rrëshen, larguar datë 18.7.2011.
- [REDAKTUAR] ish- n/kryetar i Bashkisë Rrëshen, larguar datë 18.7.2011.
- [REDAKTUAR] ish- shefi i Departamentit të Autoritetit, larguar datë 16.9.2011
- [REDAKTUAR] ish- shefe e Departamentit Ekonomik, larguar datë 6.7.2010
- [REDAKTUAR] ish- përgjegjësi i Sektorit të Urbanistikës, larguar datë 6.9.2011.
- [REDAKTUAR] ish- përgjegjësi i Sektorit të Urbanistikës, larguar datë 26.8.2011.
- [REDAKTUAR] ish-Kryeinspektori i Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik, larguar në muajin korik 2011.
- [REDAKTUAR] ish-inspektor i Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik, larguar më datën 17.10.2011.

E. KALLËZIM PENAL

Bazuar në ligjin nr. 7895, datë 27.1.1995 "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 248 "Shpërdorim detyrë", të bëhet kallëzim penal për tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, në tenderin me objekt: "Ndërtim i vend depozitës së mbetjeve të ngurta urbane" (faza II-të):

Pasi, gjatë zhvillimit të procedurave të prokurimit në funksion të Njesisë së Prokurimit, nuk kanë përmbushur në mënyrë të rregulltë dhe në përputhje me ligjin detyrën, gjë që i ka shkaktuar si pasojë një dëm ekonomik buxhetit të shtetit prej **13,206,851 lekë**.

Shënim: Auditimi u krye nga audituesit Niko Nako dhe Besim Bileri. Më tej u shqyrtua nga Kryeaudituesi i Departamentit Miranda Haxhia, Drejtori i Departamentit Pullumb Beqiraj, Drejtori i Drejtorisë Juridike dhe Kontrollit të Cilësisë, si dhe u verifikua si praktikë nga Drejtori i Përgjithshëm Helga Vukaj.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT